



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “VIBTIS Dega në Kosovë” të datës 09.10.2023 përfaqësuar nga av. Isuf Zejna nga Prishtina, kundër njoftimit mbi vendimin të datës 04.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me pajisje për pastrimin e kryeqytetit” me nr. të prokurimit 616-23-7016-1-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “VIBTIS Dega në Kosovë” të datës 09.10.2023 përfaqësuar nga av. Isuf Zejna nga Prishtina, kundër njoftimit mbi vendimin të datës 04.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me pajisje për pastrimin e kryeqytetit” me nr. të prokurimit 616-23-7016-1-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “VIBTIS Dega në Kosovë” se ky aktivitet i prokurimit është kthyer në rivlerësim sipas vendimit të autoritetit kontraktues të datës 09.10.2023 për shkak të kërkesës për rishqyrtim të një tenderuesi tjetër në këtë aktivitet.
- IV. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “VIBTIS Dega në Kosovë” si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “VIBTIS Dega në Kosovë” përfaqësuar nga av. Isuf Zejna nga Prishtina (tutje “parashtruesi”) me datë 09.10.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 04.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me pajisje për pastrimin e kryeqytetit” me nr. të prokurimit 616-23-7016-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet kryesore të parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) - *“Nga arsytimi i Autoritetit Kontraktues të publikuar në Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, thuhet se kinse qarkullimi specifik i Ankuesit është në vlerë prej 1,903,196.70 Euro dhe jo 2,000,000 Euro siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit. Së pari duhet të sqarohet se të gjitha të dhënat e paraqitura në Aneksin 6, janë dhënë pa përfshirë vlerën e TVSH e cila në Republikën e Shqipërisë është 20 përqind. Autoriteti Kontraktues nuk ka marrë në konsideratë këtë dhe këto vlera i ka kalkuluar pa marrë parasysh këtë fakt. Në këtë mënyrë ka ardhur deri tek konstatimi i gabuar se Ankuesi nuk i plotëson kriteret e qarkullimit specifik në vlerë prej 2,000,000 Euro”.*

Pretendimi i dytë (II) - *“I rekomanduari për kontratë nuk plotëson kriteret për qarkullimin në natyrë të kontratës”.*

Pretendimi i tretë (III) - *“Oferta e konsorciumit d&t group dhe kosova motors është e papërgjeshme për ofrim të dhënave të pasakta si dhe ofertim me dy prodhues të ndryshëm”.*

Lidhur me pretendimin e parë (I) ankimor duhet sqaruar se ky pretendim ka të bëjë me kërkesën e dosjes së tenderit të formuluar si në vijim:

Kapaciteti teknik dhe profesional	Dëshmia e kërkuar dokumentare:
1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka furnizuar me sukses kontrata të kësaj natyre, ose të ngjajshme me vlerë minimale prej 2,000,000.00€, në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë.	1. Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve.

Nga administrimi i dosjes me të cilën ka ofertuar parashtruesi është gjetur se i njëjti në aneksin 6 ka evidentuar dy (2) kontrata të evidentuara si në vijim:

Aneksi 6. KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS ²							
Ky Aneks është obligativ që të plotësohet dhe të bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër që evidenton performimin e tillë)							
NR.	Titulli i kontratës	Data e nënshkrimit të kontratës	Data e përfundimit të kontratës	Vlera totale e kontratës	Emri i Blerësit	E-maili i Blerësit	Numri i telefonit të Blerësit
1	Procurement of Equipment for collection and transport of municipal waste and Procurement of Street Sweeping Equipment for Vloca and Selenica Municipalities, Albania	24.08.2021	31.08.2022	3,668,309.41 EUR Without VAT	National Agency of Water and Sewerage and Waste Infrastructure (AKUM) Final Beneficiary: Vloca Municipality	akum@akum.gov.al	+35542256091
2	Procurement of goods: Lot 1 - Waste collection and landfill mobile equipment; Lot 3 - Landfill basic operation equipment	15.06.2022	30.04.2023	609,288.58 EUR Without VAT	Korca Regional Waste Management Company (KRWM)	info@krwm.al	+355692065112



Nga aneksi 6 i plotësuar nga parashtruesi sikurse më sipër, mund të vërehet se për kontratën e parë nuk ka qenë vetëm parashtruesi si palë e kontraktuar por ka qenë edhe një operator tjetër ekonomik. Në fakt, sa i përket kontratës së parë si dëshmi dokumentare parashtruesi ka dorëzuar edhe një formular të vlerësimit nga autoriteti përkatës kontraktues ku thuhet se parashtruesi "Vibtis" Sh.P.K. ka realizuar vetëm 35% të punëve të përcaktuara me këtë kontratë. Nëse nisemi nga ky fakt mund të konfirmohet po ashtu se parashtruesi është paguar vetëm për 35% të vlerës së përgjithshme të kontratës (për aq punë sa ka kryer). Tutje përmes të njëjtit formular të vlerësimit është përcaktuar se vlera e përgjithshme e kontratës është 3,668,309.41 euro. Kjo nënkupton që vlera e kontratës sipas participimit për parashtruesin është 1,283,908.29 euro. Nëse kësaj i shtohet edhe vlera e kontratës së dytë që është evidentuar në aneksin 6 atëherë vlera e përgjithshme e kontratave sipas aneksin 6 arrihet gjithsej 1,903,196.87 euro (vlera e përgjithshme - bruto). Kjo vlerë është vlerë e përgjithshme (bruto) e përcaktuar si e tillë përmes dëshmimeve dokumentare që ka dorëzuar parashtruesi (pra nuk bëhet fjalë për shumën neto sikurse pretendon parashtruesi). Mbi të gjitha kjo shumë e përgjithshme - bruto është dukshëm më e vogël se vlera prej 2,000,000.00 euro që është kërkuar përmes dosjes së tenderit. Në këtë mënyrë është gjetur se ky pretendim ankimor i parashtruesit është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e dytë (II) dhe pretendimin e tretë (III) ankimor, duhet theksuar se parashtruesi këto pretendime i ka drejtuar kundër tenderuesit të rekomanduar dhe kundër një tenderuesi tjetër në këtë aktivitet të prokurimit. Në anën tjetër vet parashtruesi sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 04.10.2023 është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm. Duke marrë parasysh faktin se parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, i njëjti nuk mund të dëshmojë asnjë interes material në kuptim të pretendimeve që i ka drejtuar kundër tenderuesve të tjerë në këtë aktivitet të prokurimit. Kjo pasi që për parashtruesin është jorelevante nëse tenderuesit e tjerë janë të përgjegjshëm ose jo përderisa vet parashtruesi është i papërgjegjshëm dhe përmes kërkesës për rishqyrtim nuk arrin të agrumentoj përgjegjshmërinë e ofertës së tij. Në këtë drejtim përmes nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP është përcaktuar se *"Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar"*. Tutje përmes nenit 59 paragrafit 59.1 të RRPP është përcaktuar se *"kërkesa për rishqyrtim mund të dorëzohet, pa pagese, nga cilado palë e interesuar..."*. Ndërsa përmes nenit 62 paragrafit 62.1 nënparagrafit b) të RRPP është përcaktuar se *"Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur kërkesa nuk është paraqitur kundër një njoftimi ose vendimi siç referohet në nenin 59.1 të kësaj rregullore"*. Në këtë mënyrë është gjetur se këto dy pretendime të parashtruesit janë të pabazuara në kuptim të nenit 62 paragrafit 62.1 nënparagrafit b) lidhur me nenin 59 paragrafin 59.1 të RRPP si dhe lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nënparagrafin 26 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP.

Për pikën III, IV dhe V të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 16.10.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtoj ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.